




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ky raport ka rezultuar me tri (3) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim është i ri dhe dy (2) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 1,238,714€, prej tyre ishin shpenzuar 961,941€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, qiraja për ndërtesa, qiraja për përdorime tjera hapësinore, shpenzimet për informim publik, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, shpenzime komunale, etj.

Çështja A1 - Mangësi në vlerësimin e ofertës

Gjetja Neni 59 pika 4 e Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, specifikon që: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në procedurën "Ofrimi i shërbimeve për marketing, dizajn, video-produksion dhe publikim në portale" në vlerë 67,472€, të kërkesa III.2.4, në njoftimin për kontratë, lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, është kërkuar staf profesional, konkretisht një video editor me dëshmitë e kërkuar CV, Referenca dhe Portfolio. Përderisa, në dosje mungonin referencat për pozitën e kërkuar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së përgjegjësisë nga ana e anëtarëve të komisionit gjatë vlerësimit të tenderëve.

Ndikimi Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave ndikon në shpërblimin me kontratë të OE të pa përgjegjshëm. Po ashtu, rritë rrezikun që realizimi i kontratës të mos arrijë qëllimin e synuar.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që komisioni i vlerësimit kryen vlerësimin në pajtueshmëri të plotë me kërkesat që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës

Gjetja Rregulla Financiare nr 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, neni 22 procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave përcakton hapat që duhet ndjekur. Fillimisht bëhet kërkesa për blerje, pranimi i mallit/shërbimit dhe pastaj OE e sjellë faturën për pagesë.

Gjatë testimit të pagesave në AKP kemi vërejtur tetë (8) raste në vlerë totale 66,381€, kur urdhër blerjet ishin proceduar pasi kishte ardhur fatura. Sa për ilustrim me rastin e pagesës "Furnizim me material higjienik, në vlerë 5,297€" sipas Kontratës, neni 2.1 kushtet e dërgesës, afati kohor për dorëzim ishte 48 orë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e AK, ndonëse OE ishte vonuar 13 ditë për liferim malli ishte e pa mundur aplikimi

i penaleve pasi Urdhër blerja ishte nxjerr tetë ditë pasi kishte ardhur malli, dhe porosia ishte bërë me email.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhër blerjës.

Ndikimi

Pranimi i mallrave dhe shërbimeve si dhe faturës para se të procedohet urdhër blerja përveç që paraqet shmangie të procedurave të përcaktuara me rregulla financiare njëkohësisht pamundëson përcjelljen e implementimit të kontratës sa i përket liferimit të mallit.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që, urdhër blerjet lëshohen para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blerjet e pa kontrolluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 62,876€, pasurive jokapitale është 101,959€, si dhe e stoqeve 20,420€.

Çështja B2 - Mos funksionimi i sistemit "e-pasuria"

Gjetja

Sipas nenit 6.3 të rregullores 02/2013 për Menaxhim të Pasurive jo financiare: Pasuria kapitale do të regjistrohet në SIMFK ndërsa ajo jo-kapitale dhe stoqet në sistemin e-pasuria.

AKP edhe pse kishte themeluar një komision për vendosjen e shënimeve në sistemin e-pasuria, as këtë vit nuk kishte arritur që të funksionalizojë këtë sistem. Për qëllime të brendshme dhe të raportimit të pasurisë jo kapitale kishin përdorur regjistër të brendshëm.

Kjo ka ndodhur për shkak se kishte probleme (dyfishim të të dhënave, artikuj me vlerë zero si dhe atikuj me vlerë të shumëfishuar) gjatë vendosjes së shënimeve në sistem për pasurinë jo kapitale.

Ndikimi

Mos funksionalizimi i sistemit të e-pasurisë ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore për menaxhim të pasurisë. Po ashtu, regjistrimi i pasurive jo kapitale në Excel ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë, rritë rrezikun që informatat e shpalosura në PFV mund të jenë të pasakta dhe jo të plota.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtorëve duhet të marrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion të plotë sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	5,698,956	4,874,485	4,594,243	5,944,598	6,531,932
Grante Qeveritare - Buxheti	5,698,956	4,874,485	4,594,243	5,944,598	6,531,932

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 824,471€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i ndryshimit buxhetor dhe tri vendimeve të Qeverisë: me nr.69-1/2023, nr.16/174 dhe nr.40/178, për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore.

Në vitin 2023 AKP-ja ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar ose 4,594,243€, në raport me vitin paraprak kemi një ulje prej 1% (2022 - 95%), përderisa totali i shpenzimeve në vitin 2023 në raport me vitin parapark ishte zvogëluar për 29%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	5,698,956	4,874,485	4,594,243	5,944,598	6,531,932
Pagat dhe mëditjet	4,211,752	3,620,071	3,619,603	4,926,016	5,348,022
Mallrat dhe shërbimet	1,312,204	1,088,714	879,369	883,787	1,079,742
Komunalitë	150,000	150,000	82,572	100,680	61,419
Subvencionet dhe transferet	5,000	0	0	0	0
Investimet Kapitale	20,000	15,700	12,700	34,115	42,749

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 591,681€, si rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 69-1/2023 me datën 28.12.2023. Këto mjete janë tërhequr si kursime buxhetore. Buxheti final ishte realizuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 223,490€, si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.40/178 me datën 13.12.2023 për kursime buxhetore. Buxheti final ishte realizuar në masën prej 81%;
- Buxheti final për shpenzimet komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte i njëjtë. Realizimi i shpenzimeve ishte në vlerë 82,571.64€ apo 55%;
- Buxheti fillestar për subvencione dhe transfere ishte në vlerë 5,000€, me vendim të Qeverisë nr.40/178 ky buxhet për shkak të mos shpenzimit është marrë si kursim buxhetor; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,300€, ky ndryshim është bërë me vendim të Qeverisë nr.16/174 për kursime buxhetore.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	496	496		1,220	
Të hyrat jo tatimore	496	496		1,220	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të AKP-së ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. AKP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2023, pesë (5) rekomandime janë zbatuar përderisa dy (2) të tjera nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 ose (Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Bordi i Drejtorëve me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimin e aktiviteteve normale në të gjitha njësitë, duhet të sigurojë që të bëhet rishikimi dhe përditësimi i planit.	AKP gjatë vitit 2023 ka bërë sistematizimin e stafit sipas rregullores së aprovuar nga BD	I zbatuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë kontrolle dhe monitorim të evidentimit të stafit në sistemin elektronik të vijueshmërisë hyrje/dalje me qëllim të mbarëvajtjes së vijueshmërisë në punë.	AKP gjatë vitit ka marrë masa për monitorimin e vajtje ardhjes së stafit	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që janë respektuar kërkesat ligjore në rastet e mbulimit të pozitave me zëvendësime.	AKP gjatë vitit nuk ka pasur pozita me Ushtrues detyre më të gjatë se afati i paraparë	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave realizohet brenda afateve të përcaktuara kohore, duke mundësuar që mallrat/shërbimet të pranohen në kohën e duhur.	Gjatë testimeve të bëra të dosjeve të prokurimit për vitin 2023, nuk kemi hasur në mos respektim të afateve kohore për vlerësim të tendereve.	I zbatuar
5.	Çështjet e përbashkëta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që të nxjerrën urdhërblert për para se të pranohen mallrat dhe faturat në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blertjet e pa kontrolluara.	Raste të ngjashme përsëriten edhe gjatë vitit 2023 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Referenca B1	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Pasuritë	Bordi i Drejtorëve duhet të marrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria.	Edhe këtë vit nuk është funksionalizuar sistemi e-pasuria. Referenca B2	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Auditimi i Brendshëm	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë së emërimi i anëtarëve të Komitetit të Auditimit të bëhet konform kërkesave të përcaktuara me ligjin për Kontrollin e brendshëm të financave publike.	Është formuar Komiteti i auditimit sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në vlerësimin e ofertës	Gjatë vlerësimit të ofertave për kërkesat tekniko profesionale por edhe për kërkesa tjera Udhëzuesi nr.001/2023 për Prokurim Publik përcakton rastet kur kërkohe sqarime dhe plotësime të dokumenteve për kriteret e caktuara. Gjithashtu, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik parashohin “Nëse për ndonjë arsye valide, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues në pajtim me nenet 69 të LPP-së, operatori ekonomik në fjalë mund të lejohet që të tregojnë aftësitë teknike dhe /ose profesionale përmes ndonjë dokumenti tjetër që autoriteti kontraktues, duke siguruar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik, i konsideron të përshtatshme” (f.93/94). Komisioni i vlerësimit ka pas të drejtë të kërkojë sqarime dhe dokumentacion shtesë por duke marrë në konsideratë dokumentacionin para datës së dorëzimit të ofertave, Komisioni nuk e ka bërë një gjë të tillë pasi që ka konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar në OE i rekomanduar për dhënien e kontratës ka plotësuar kërkesën e kërkuar, bazuar në: Në dokumentin e dorëzuar nga OE për pozitën e kërkuar, nga CV e prezantuar shihet që e tërë përvoja profesionale e personit të prezantuar në cilësinë e pozitës së kërkuar (video editor) është në kompaninë ofertuese, rrjedhimisht vet përfshirja e këtij personi si pjesë e stafit profesional të kërkuar në kuadër të ofertës, mund të konsiderohet si referencë, përderisa referenca si dokument kërkohe për të dëshmuar përvojën. Për më tepër, është prezantuar lista e punimeve si referencë dhe portfolio.	Ne analizuam komentin/arsyetimin e përcjellur nga AKP lidhur me çështjen A1 të paraqitur në raport. Lidhur me këtë çështje AKP nuk ka përcjellur dëshmi shtesë, përveq atyre të cilat na janë ofruar gjatë auditimit. Në dosjen e tenderit ‘Ofrimi i shërbimeve për marketing, dizajn, video-produksion dhe publikim në portale’ ndër tjera, është kërkuar që: Tenderuesi duhet të ketë staf profesional të punësuar në kompani, të kenë përvojë profesionale të cilat duhet të dëshmohe me CV, Referencë dhe portfolio. Fituesit i mungonin referencat për pozitën e kërkuar. Më tej, sipas komisionit të vlerësimit, njëri nga ofertuesit ishte eliminuar pikërisht si rezultat i mungesës së këtyre dëshmive (referenca për pozitën e kërkuar). E gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
Nr. Bg. No. 1576	
Nr. I Fq. 3	Data 2. 04. 2024
Nr. Str. 3	Data 1. 04. 2024
Prishtinë / Pristina	

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**
Auditorë e Përgjithshme
Zyra Kombëtare e Auditimit

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRILAVEN / DATE PRILAVEN / DATE PRILAVEN			
Nr. Org. 05	Shif. Klasif. 47	Nr. Prot. 440	Nr. Faqeve 3
Org. Jedin. Org. Unit	Klasif. Kod Class. Code	Str. Prot. Prot. No.	Br. Stranica No. Pages

E nderuar znj. Spanca,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, përveç çështjes A1 që kemi komente; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit Final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,


Arben Limani
Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 18 prill 2024

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.